

PARTIA "ALEANCA PER DEMOKRACI DHE SOLIDARITET"

RAPORTI I AUDITUESIT TE PAVARUR

PER

**PASQYRA E FONDEVE TE PERFITUARA DHE SHPENZIMEVE TE
KRYERA**

**GJATE VITIT USHTRIMOR 2014
01 JANAR 2014 – 31 DHJETOR 2014**

MBYLLUR ME 31.12.2014



ALB-AUDIT

ALB-AUDIT sh.p.k

Rr. EMIN DURAKU

Nd.2, H. 6, Ap. 10

Njesia Bashkiake Nr.5, Kodi Postar 1019

TIRANE

NIPT : L 01417011 K

Tel/fax +35542251744, Cel. 0692042251

Email.albaudit@gmail.com :hsulai@yahoo.com .

RAPORTIAUDITUESITTEPAVARUR

PER PASQYREN E FONDEVE TE PERFITUARA DHE SHPENZIMEVE TE KRYERA, NE VITITN KALENDARIK, 2014, NGA PARTIA "ALEANCA PER DEMOKRACI DHE SOLIDARITET".

Drejtuar : KOMISIONIT QENDROR TE ZGJEDHJEVE

Adresa : Pallati i Kongreseve, Tirane Shqiperi

Ne kemi audituar pasqyren bashkalidhur te fondeve te perfituara dhe te shpenzuara per vitin kalendarik 2014 te kryera nga Partia "Aleanca per Demokraci dhe Solidaritet", qe perfshin periudhen 01 Janar deri me 31 Dhjetor 2014.

Pasqyra është përgjegjësi e drejtimit të Partise " Aleanca per Demokraci dhe Solidaritet".

Kjo pasqyrë financiare është përgatitur nga drejtimi i Partia " Aleanca per Demokraci dhe Solidaritet" bazuar ne librin e llogarive sipas metodes se arketim – pagesa, të cilët janë mbajtur për të pasqyruar të gjithë transaksionet në lidhje me vitin kalendarik 01.01.2014-31.12.2014, që kanë dhënë bazën për përgatitjen e pasqyrës bashkalidhur. Politika kontabile e ndjekur nga ana e drejtimit eshte, te pergatise pasqyren bashkalidhur mbi bazen e fondeve te perfituara dhe shpenzimeve te realizuara gjate periudhes ushtrimore te vitit 2014. Mbi kete baze, fondet e perfituara njihen kur fitohen ne leke ose ne material dhe sherbime te konvertuara dhe shpenzimet njihen si te tilla ne momentin qe ato jane kryer dhe jo kur ato paguhen.

Përgjegjësia jone është të shprehim një opinion mbi këtë pasqyrë bazuar në auditimin e kryer.

Ne kemi kryer auditimin ne perputhje me Standartet Ndërkombëtare të Auditimit në referencë të vecantë me SNA 800 "Konsiderata të vecanta-Auditimet e pasqyrave financiare të përgatitura sipas kuadrove për qëllime specifike". Këto standarte

kërkojnë që ne të veprojmë në pajtim me kërkesat e etikës dhe të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme për faktin që pasqyra financiare e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara për vitin kalendarik 2014 të mos përmbajë anomali materiale.

Një auditim përfshin kryerjen e procedurave për të siguruar evidencë auditimi në lidhje me shumat dhe informacionet e dhëna në pasqyrën bashkëlidhur. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit dhe përfshijnë vlerësimin e rreziqeve të anomalisë materiale të pasqyrës përkatëse, qoftë për shkak të mashtrimit, ashtu dhe të gabimit. Për vlerësimin e këtyre rreziqeve, audituesi konsideron kontrollin e brendshëm të drejtimit që ka të bëjë me përgatitjen e pasqyrës me qëllim që ai të përcaktojë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat, por jo për qëllim të shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të saj. Auditimi përfshin gjithashtu shqyrtimin mbi bazën e testeve, të fakteve që mbështesin shumat dhe deklaratimet në pasqyrën financiare, vlerësimin e parimeve kontabël të përdorura të vlerësimeve të rëndësishme të bëra nga drejtimi si dhe një vlerësim të paraqitjes së përgjithshme të pasqyrës.

Ne çmojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë të auditimit.

Ceshtje ne Vemendjen Tuaj

Ne kerkojme vemendjen tuaj ne lidhje me ,

Ne kerkojme vemendjen tuaj ne lidhje me ,

Detyra e subjektit zgjedhor , ALEANCA PER DEMOKRACI DHE SOLIDARITET, është të përgatisë pasqyrën financiare mbi bazën e arkëtimit dhe pagesave.(subjekti deklaron se nuk ka përfituar asnjë fond publik dhe jopublik dhe nuk ka bere shpenzime).

Opinion

*Sipas mendimit tonë, duke marrë në konsiderat Ceshtje ne Vemendjen Tuaj, pasqyra (deklarata) e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara për fushatën zgjedhore ne organet e qeverisjes vendore date 21 Qershor 2015 e **Partise ALEANCA PER DEMOKRACI DHE SOLIDARITET**, është përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kërkesat e raportimit mbi bazën e arkëtimit dhe të pagesave , konform me ligjin nr 9228 datë 29/04/2004 “ Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare’.*

Tirane , me 25 Tetor 2015

ALB-AUDIT sh.p.k

Hetem SULAJ

EKSPERT KONTABEL I REGJISTRUAR